

**VENDIM**  
**Nr. 511, datë 30.8.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR  
TRANSFERIMIN E PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS NË  
STRUKTURA TË TJERA ME GRADË, NË VARËSI TË MINISTRISË  
PËRGJEGJËSE PËR RENDIN DHE SIGURINË PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Punonjësit e Gardës së Republikës mund të transferohen, për arsye shërbimi, në struktura të tjera me gradë, në varësi të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, me kërkesën e këtyre të fundit.

2. Punonjësit, të cilët transferohen në struktura të tjera me gradë, emërohen në funksion në nivel ekuivalent me gradën që kanë.

3. Titullarët e institucioneve kërkuese, të cilët shprehin interes për emërimin e punonjësve të Gardës së Republikës në strukturat e tyre, paraqesin kërkesën me shkrim pranë drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës, duke specifikuar kriteret dhe kualifikimin që duhet për të kryer detyrën.

4. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, për çdo funksion të kërkuar nga institucionet kërkuese, përzgjedh kandidaturën që plotëson kriteret e kërkuara dhe e përcjell atë tek institucioni kërkues, së bashku me dokumentacionin që vërteton kualifikimin e tij për pozicionin e propozuar.

5. Kur kandidatura e përzgjedhur mban gradën “Drejtues i lartë”, transferimi bëhet me urdhër të ministrit, pas propozimit të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës.

6. Institucioni kërkues, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kandidaturës së propozuar, sipas pikave 4 dhe 5, të këtij vendimi, shprehet me shkrim për pranimin ose jo të tij.

7. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës, pas marrjes së dakordësisë, nxjerr urdhrin e transferimit të punonjësit dhe ia përcjell atë institucionit kërkues, së bashku me dosjen personale.

8. Drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës ka të drejtë që për nevoja pune të kërkojë rikthimin e punonjësit në Gardën e Republikës, para plotësimit të afatit të transferimit, por jo më parë se 6 (gjashtë) muaj nga transferimi.

9. Punonjësi i transferuar pranë strukturave/institucioneve të tjera me gradë, në varësi të ministrisë, sipas këtij vendimi, në përfundim të periudhës së qëndrimit në detyrë, ka të drejtë të rikthehet në strukturat e Gardës në një funksion, në përputhje me gradën që mban aktualisht.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Garda e Republikës, Policia e Shtetit dhe strukturat e tjera me gradë në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**